



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry



Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovo Standardisation Agency
Kosovska Agencija za Standardizaciju

Raport i realizimit të planit të punës
AKS 2020

Plani i punës
AKS 2021

Përmbajtja:

1. Roli dhe rëndësia e standardizimit
2. Korniza ligjore e AKS
3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)
4. Komitetet Teknike (KT)
5. Standardet e adoptuara SK
6. Standardet e shfuqizuara
7. Standardet e shitura
8. Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit
9. Aktivitetet promovuese të AKS
10. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS
11. Buxheti i AKS
12. Grupet punuese/komisione
13. Raporte/kërkesa/takime
14. Trajnimet
15. Mbështetje teknike nga projekti FMG II
16. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve të AKS
17. Sfidat e standardizimit kosovar
18. Plani i punës - AKS 2021

1. Roli dhe rëndësia e standardizimit

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), është institucion i vetëm shtetëror i cili siguron platformë për zhvillimin e standardizimit, duke mbështetur cilësinë dhe sigurinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve si dhe përhapjen e njohurive përmes standardeve, të cilat në mënyrë të vazhdueshme i zhvillon/adopton/miraton duke i dhënë prioritet atyre që kërkohen nga palët e interesit, ato që kanë më shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit dhe standardet të cilat janë referencë në direktivat evropiane (të transpozuar në legjislacion vendor). AKS zhvillon Standarde Kosovare për të gjitha palët e interesit dhe punon së bashku me rreth 130 ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët aktivizohen në grupe punuese të Këshillit Profesional të Standardizimit dhe të Komiteteve Teknike.

2. Korniza ligjore e AKS

Baza ligjore e AKS tashmë është e kompletuar dhe e përafëruar me *acquis* të BE, megjithatë janë edhe disa procedura të cilat duhet të plotësohen në formë të rregulloreve të brendshme. Në këtë kuptim, korniza ligjore e AKS, është plotësuar me:

- a) Rregulloren e brendshme nr. 02/2020 për rregullat dhe procedurat për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve evropiane si standarde kosovare (20.03.2020); dhe
- b) Marrëveshjen Licencë ndërmjet AKS-CEN/CENELEC;
- c) Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit AKS dhe Kolegji “Tempulli”.
- d) Përgatitja e standardeve të harmonizuara që janë referencë në direktivat evropiane, për publikim në Gazetën Zyrtare.

3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)

Këshilli Profesional i Standardizimit është trup këshillëdhënës, i cili funksionon në kuadër të AKS dhe si i tillë trajton programet e punës, përbërjen dhe drejtimin e Komiteteve Teknike. KPS ka mbajtur dy takime të rregullta gjatë vitit 2020, të cilët kanë shqyrtuar raportin e punës dhe planin e punës për vitin 2020:

- Takimi i mbajtur me 16.01.2020; dhe
- Takimi i mbajtur me 14.10.2020.

4. Komitetet Teknike (KT)

Komitetet Teknike janë grupe ekspertësh të deleguara nga institucione/organizata/biznese, të cilat veprojnë në fusha të caktuara të ekonomisë e që janë të përfshirë në procesin e standardizimit, respektivisht në hartimin dhe adoptimin e standardeve kosovare. KT mbledhen në bazë të kërkesave nga palët e interesit dhe si të tilla gjatë vitit 2020 janë mbajtur gjithsej 42 takime nga komitete teknike të ndryshme (tabela nr. 1):

- KT për Energji (2);
- KT për Mjedis (4);
- KT për Ndërtim (4);
- KT për Makineri (5);
- KT për Shëndetësi (3);
- KT për Metrologji (2);
- KT për Elektroteknikë (1);
- KT për Përpunim Druri (3);
- KT për Miniera dhe Minerale (3)
- KT për Teknologji Informative (1);
- KT për Eurokode për Struktura (2);
- KT për Teknologji Agroushqimore (1);
- KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (2);
- KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (4);
- KT për Transport dhe Shërbime Postare (3);
- KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (2).

Tabela nr. 1. Takimet e komiteteve teknike




Gjithashtu është plotësuar/ndryshuar dhe menaxhuar në vazhdimësi lista me bazat deleguese të anëtarëve të të gjitha komiteteve teknike.

5. Standardet e adoptuara SK

AKS në vazhdimësi zhvillon standarde të cilat janë me prioritet për ekonominë e vendit, industrinë dhe gjithashtu për plotësim të legjislacionit teknik me theks të veçantë për rregullore teknike të cilat i referohen standardeve. Janë gjithsejtë 516 standarde EN dhe ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare SK (tabela nr. 2):

- ✓ KT për Energji (5 SK)
- ✓ KT për Mjedis (34 SK)
- ✓ KT për Ndërtim (59 SK)
- ✓ KT për Makineri (158 SK)
- ✓ KT për Shëndetësi (28 SK)
- ✓ KT për Metrologji (19 SK)
- ✓ KT për Elektroteknikë (5 SK)
- ✓ KT për Përpunim Druri (10 SK)
- ✓ KT për Miniera dhe Minerale (15 SK)
- ✓ KT për Eurokode për Struktura (14 SK)
- ✓ KT për Teknologji Agroushqimore (5 SK)
- ✓ KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (40 SK)
- ✓ KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (81 SK)
- ✓ KT për Transport dhe Shërbime Postare (16 SK)
- ✓ KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (27 SK)

Tabela nr. 2. Standardet e adoptuara




6. Standardet e shfuqizuara

Për të siguruar që standardet janë në fuqi, sekretarët e komiteteve teknike (zyrtarët e AKS) në vazhdimësi duhet t'i rishikojnë ato në një periudhë nga një deri në pesë vjet. Standardet mund të rishikohen edhe më shpejt nëse ka kërkesë nga palët e interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale. Në total janë 490 standarde kosovare të cilat janë shfuqizuar (tabela nr. 3):

- KT për Energji (4 SK)
- KT për Mjedis (26 SK)
- KT për Ndërtim (86 SK)
- KT për Makineri (10 SK)
- KT për Shëndetësi (48 SK)
- KT për Metrologji (21 SK)
- KT për Elektroteknikë (78 SK)
- KT për Përpunim Druri (1 SK)
- KT për Teknologji Informative (16 SK)
- KT për Pajisje Mbrojtëse Personale (3 SK)
- KT për Teknologji Agroushqimore (56 SK)
- KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (41 SK)
- KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (18 SK)
- KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (16 SK)
- KT për Transport dhe Shërbime Postare (24 SK)
- KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (42 SK)

Tabela nr. 3. Standardet e shfuqizuara



7. Standardet e shitura

Standardet janë dokumente teknike të cilat zhvillohen në komitete teknike dhe pasi miratohen nga AKS bëhen publike për të gjitha palët e interesit. Çdo kush pastaj mund të blen standarde, e cila bëhet duke identifikuar standardet e duhura dhe duke dërguar kërkesën në adresën aksinfo@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në zyrat e AKS ose edhe nëpërmjet telefonit 038/512-779, dhe në momentin kur konfirmohet pagesa e faturës, standardi bëhet i gatshëm për blerësin. Në total gjatë vitit 2020, janë shitur 150 standarde kosovare, në vlerën 3,109.00 € për 46 biznese, individë apo institucione. Kryesisht këtë vit, standardet më të kërkuara kanë qenë ato të akreditimit të laboratorëve, produkteve të ndërtimit dhe sistemeve të menaxhimit në përgjithësi.

8. Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit

Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit, AKS është e obliguar të raporton lidhur me standardet e adoptuara dhe të shitura tek organizatat e standardizimit CEN-CENELEC dhe DPS. Në këtë kuptim, AKS ka realizuar:

- Menaxhimi i marrëveshjes së bashkëpunimit AKS-CEN;
- Menaxhimi i marrëveshjes së bashkëpunimit AKS-CENELEC;
- Menaxhimi i marrëveshjes së bashkëpunimit AKS-DPS;
- Notifikimi i standardeve të adoptuara në CEN/CENELEC;
- Notifikimi i standardeve të shitura në CEN/CENELEC;
- Notifikimi i standardeve të adoptuara në DPS; dhe
- Notifikimi i standardeve të shitura në DPS.

9. Aktivitete promovuese të AKS

Promovimi dhe publikimi i secilit standard kosovar, pastaj zhvillimi i mëtejshmë i politikave dhe programeve të AKS dhe rolit e rëndësishë të standardeve dhe standardizimit në përgjithësi kanë qenë dhe mbeten prioritet i AKS. Të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar online në <http://www.aks.rks-gov.net>, Gjatë këtij viti AKS ka promovuar rolin dhe rëndësinë e standardeve:

- a) Prezantim katër ditor me temën “Roli dhe rëndësia e standardeve” për SHM “Hoxhë K. Prishtina”
- b) Ligjëratë me studentët e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini;
- c) Prezantim i rolit dhe rëndësishë të standardeve në workshopin e MZHE.

Gjithashtu, është krijuar www.facebook.com/MTI.AKS, ku gjatë gjithë vitit janë publikuar aktivitete të rëndësishme të standardizimit. Po ashtu është përgatitur dhe publikuar “Katalogu i Standardeve Kosovare 2020”, dhe i njëjti është shpërndarë në format elektronik tek të gjitha palët e interesuara. Janë kontaktuar kompani biznesi të ndryshme, ku ju është

dhënë informacion mbi standardet, zbatimin e tyre, certifikimin, rregulloret teknike të cilat kanë referencë standardet, dhe të tjera sipas kërkesave. Në AKS është realizuar edhe një praktikë profesionale për një studente të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, dhe janë përgatitur referenca sipas kërkesave për anëtarët e angazhuar në komitete teknike.

10. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS

Databaza e Standardeve Kosovare (Sistemi SMIS), siguron porosi online për shitjen e standardeve, gjë që rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj bizneseve dhe çdo pale tjetër të interesuar për standarde, duke shkurtuar kohën dhe kostot e tyre për blerjen e standardeve. Gjithashtu kjo databazë, përmes lidhjes me ueb faqe, ofron identifikim më të lehtë të standardeve dhe lexim falas në zyre të AKS nga çdokush që është i interesuar për të lexuar tekstin e standardeve. Sistemi SMIS shfrytëzohet me “user name” nga i gjithë stafi (7 sekretarët e komiteteve teknike) dhe përmban aktivitete si:

- Plotësime të SMIS me akte të reja ligjore.
- Identifikimi i materialeve në SMIS që nevojiten për ndryshime.
- Plotësimet e referencave të standardeve.
- Plotësimet e “mirrore” të standardeve.
- Krijimi i user name dhe passwordit për palët e interesit.
- Krijimi i linçeve të reja në AKS ueb.
- Ndryshimet e strukturës vizuale të AKS ueb.
- Identifikimi i problemeve në SMIS, mos shfaqja e standardeve në ueb të AKS.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk përputhen me çmimet.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk kanë pdf file.
- Futja e të dhënave në data bazë dhe identifikimi i standardeve të dublikuara.
- Identifikimi i standardeve të shfuqizuara.
- Përpilimi i listave në Komitete Teknike me standarde të shfuqizuara.
- Përpunimi i fjalorit terminologjik të standardeve.
- Identifikimi i standardeve të harmonizuara.
- Download i standardeve (CEN/CENELEC iProjex).
- Back Up System.

11. Buxheti i AKS

Shpenzimi i buxhetit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit për vitin 2020 nuk është realizuar në shkallë të mjaftueshme, për shkak të standardeve që i marrim nga CEN/CENELEC pa pagesë, ato nga DPS me 50 % lirim, dhe mos anëtarësimi të AKS në ISO/IEC dhe CEN/CENELEC (shpenzime për anëtarësim). Gjithashtu, për shkak të pandemisë COVID-19, nuk janë realizuar disa aktivitete me ndikim buxhetor, si dhe buxheti është shkurtuar disa herë.

12. Grupet punuese/komisionet

Zyrtarët e AKS kanë qenë mjaft të angazhuar nëpër grupe punuese dhe komisione të ndryshme brenda dhe jashtë AKS/MTI, si:

- Grupi punues për vlerësimin e kërkesave për vazhdim të autorizimit të trupave për vlerësim të konformitetit.
- Grupi punues në Këshillin Profesional të Akreditimit.
- Komisioni për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit të derivateve të naftës.
- Komisioni për vlerësimin e kushteve teknike të subjekteve që merren me tregtimin e derivateve të naftës.
- Komisioni për emërim të trupave për vlerësimin e konformitetit për pajisjet nën presion.
- Komisioni për përcaktimin e numrit të parametrave që testohen gjatë monitorimit të cilësisë në tregun e brendshëm.
- Komisioni për vlerësimin e kushteve për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për mjetet matëse në Qendrat e Kontrollit Teknik të Automjeteve.
- Komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare.
- Komisioni për vlerësimin e kushteve për autorizimin e TVK për ashensorë dhe komponentët e tyre të sigurisë.
- Komisioni për pranimin-dorëzimin e detyrave të Sekretarit të Përgjithshëm të MTI.
- Grupi punues për hartimin e rregullores së brendshme për rregullat dhe procedurat për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve evropiane dhe kosovare.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për kushtet dhe kërkesat rregullatore për vendosjen e çimentos në treg.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për përcaktimin e kushteve për vendosjen e agregateve dhe mbushësve për beton në treg.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për përcaktimin e kushteve për vendosjen e betonit të lëngshëm/gatshëm në treg.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për caktimin e kushteve për vendosjen e produkteve të shtrimit nga betoni në treg.
- Grupi punues për hartimin e rregullores teknike për pajisje me gaz.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për caktimin e kushteve për vendosjen e dyerve dhe dritareve në treg.
- Grupi punues për përgatitjen e draftit fillestar të koncept dokumentit në fushën e sigurisë së përgjithshme të produkteve.
- Komiteti Teknik për Laboratorët Testues.
- Trupi Këshillëdhënës i Industrisë, Kolegji Tempulli.
- Grupi punues lidhur me përgatitjen e projekt propozimit të IPA 3.

13. Raporte/kërkesa/takime

AKS në vazhdimësi bënë raportim në baza të rregullta (javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore) dhe shqyrtim të kërkesave për të gjitha palët e interesit, si:

- Raport për Inputet II për Raportin e KE për Kosovën 2020;
- Raporte për PKZMSA;
- Raporte dhe plani i punës për KPS;
- Raporte të përgjithshme për standardizimin për kabinetin e Ministrit;
- Raporte mujore, tre mujore dhe gjashtëmujore për aktivitetet e AKS

(Departamenti i Integriteteve);

- Raporte mujore për të hyrat e AKS për zyrën e financave;
- Raporte e të hyrave të AKS për zyrën e auditimit;
- Raport lidhur me identifikimin e akteve ligjore për Planin e Veprimit për

Fushën e Pa-harmonizuar;

- Raport për Programin për Reforma në Ekonomi;
- Planifikimi i prokurimit AKS 2020;
- Planifikimi i të hyrave vetanake të AKS për 3 vitet e ardhshme (2020-2022);
- Raporte për Projektin e PTB;
- Plotësimi i Matricës: MTI Prioritetet;
- Dy “steering committee” të udhëhequra nga Drejtori i Përgjithshëm i AKS,

lidhur me Projektin e Qarkullimit të Lirë të Mallrave FMG II;

➤ Konferenca ”Ballkani Perëndimor në Tregje Globale: Mundësi të reja për tregti dhe investim” organizuar nga KIESA dhe OECD.

➤ Pjesëmarrje në takimin: Hartimi i analizës për fushën “Reformat për integrimin ekonomik për PRE 2021-2023 dhe raporti mbi implementimin e deritashëm të Masave të PRE 2020-2022;

➤ Takim pune AKS - USAID (Kosova Compete), lidhur me mundësinë e bashkëpunimit në sektorin e standardeve të ushqimit; drurit dhe teknologjisë informative.

➤ Takim online me auditorët e projektit FMG II (ROM mission for project C393799 Support for the Free movement of goods).

➤ Raporti i aktiviteteve të planifikuara në AKS: ERA 2 Key Priorities EUOK-EUSR.

Gjithashtu, AKS ka kontaktuar, shqyrtuar dhe ofruar konsulencë për shumë institucione, kompani dhe biznesi të ndryshme, ku ju është dhënë informacion mbi standardet, zbatimin e tyre, certifikimin, rregulloret teknike të cilat kanë referencë standardet, dhe të tjera sipas kërkesave, si: Hira Natyral & Organic Skin Care; VoltechZ; Arching; Team 8; ACT-Ing; Infratek; Interlab; Electra; Departamenti i Tregtisë/MTI; Instituti INKOS; Tre Pharm; Divizioni për Infrastrukturë të Cilësisë/MTI; Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit; Projekti FMG II; E&A Engineering Consulting; KEDS; Shalaj; Er Power; Be Consulted; Inspektorati i Tregut/MTI; Drejtoria e Akreditimit/MTI; Persona Fizik; KEK; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës; IKSHP; Doganat e Kosovës; Projekti i Bankës

Botërore; PunTex; Stratas Advisors; EMEA Product Stewardship and Sustainability; DEKRA Testing and Certification; Mabco Construction (MABETEX); Eco Design; Helbko; Logi Pllaka Terasë; Sony Europe B.V; Agjencia e Metrologjisë së Kosovës/MTI; Miros; KRM Pastrimi, Prishtinë; Kompani Private Pastrimi, Ferizaj; Pio Consulting; Departamenti i Minierave/MEA; Titan Beton LLC; General Mont; Eling; Man Truck & Bus Kosova - KMG LLC; Seferi Group; Logi Group; Auditimi i Brendshëm/Ministria e Infrastrukturës; Eramet Metrology Laboratory; GSI Translations Kosovo; Tahoe Trio; ELKOS Group; Europe Systems; Medi Lab HUMAN; IMK Ballkan Projekt; AK Company; Asseco SEE; Byro Projektuese Struktura; Sharrcem; Ipecontrols; Alba Group; Kosova Lab, etj.

14. Trajnimet

- ✓ Trajnim lidhur me kornizën ligjore të AKS.
- ✓ Trajnim lidhur me databazën SMIS.
- ✓ Trajnim online mbi dokumentet e Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë.
- ✓ Trajnim i Trajnerëve për Kapitullin I: Lëvizja e Lirë e Mallrave.
- ✓ Trajnim në IKAP: Kodi Etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në Shërbimin Civil.
- ✓ Trajnim në “Ciber Security” Bruksel.

15. Mbështetje teknike nga projekti FMG II

Projekti FMG, ka mbështetur AKS gjatë vitit 2020, kryesisht në asistencë teknike:

- ✓ Internship për databazën SMIS.
- ✓ Material promovues - maska me logo të AKS për mbrojtje nga COVID-19 për të gjithë anëtarët e këshillit profesional të standardizimit dhe komiteteve teknike.
- ✓ Printim i 20 kopjeve me përmbajtje të kornizës ligjore ekzistuese të AKS.
- ✓ Vizitë pune lidhur me anëtarësimin e AKS në CEN/CENELEC, përfshirë takimin me përfaqësues të Komisionit Evropian në Bruksel.

16. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve të AKS

→ Kufizimet nga pandemia COVID-19

Si pasojë e pandemisë COVID-19, AKS është përballur me kufizime të shumta si në aspektin e organizimit të takimeve nëpërmjet komiteteve teknike, promovimit të aktiviteteve të saja, e po ashtu edhe për shkak të punës së stafit me orare të kufizuara.

→ Mos anëtarësimi në CEN/CENELEC dhe ISO/IEC

Në pamundësi për të qenë anëtarë në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, AKS furnizohet me standarde EN nga një marrëveshje licencë që ka

nënshkruar me CEN/CENELEC, mirëpo e njëjta duhet të avancohet edhe më tej në mënyrë që të përshpejtohet dhe të funksionalizohet plotësisht sigurimi i standardeve.

→ Databaza SMIS

Databaza duhet patjetër të plotësohet (update & upgrade) dhe të ketë mundësi kontrolli të plotë nga AKS. Aktualisht ajo plotësohet/ndryshohet vetëm nga Ekspertë të Projektit FMG. Update & upgrade i SMIS me CEN/CENELEC është gjithashtu çështje urgjente e cila duhet të rregullohet, përfshirë shitja online e standardeve, etj.

→ Shitja online e standardeve

Është mundësuar vetëm porositja online e standardeve, ndërsa standardet nuk shiten online si pasojë e sistemit bankar por edhe për arsye të “copy right” (nuk kemi një program për të mbrojtur standardet nga kopjimi).

→ Përgatitja e standardeve për shitje

AKS ka probleme në përgatitjen e standardeve për shitje. Edhe pse ne kemi në pronësi një fotokopje shumë të mirë dhe cilësore të modelit SHARP, ajo duhet të servisohet, por kjo nuk bëhet për arsye se me kontratën e re të MTI e gjithë administrata ka vetëm fotokopje të modelit RICOH, dhe kjo fotokopje nuk printon/kopjon me cilësinë e duhur.

→ Vulosja e standardeve

Standardet të cilat AKS i përgatit për shitje duhet të vulosen, dhe meqenëse AKS nuk ka vulë të sajën, ne detyrohemi të dërgojmë standardet për vulë në Kabinetin e Ministrit. Kjo procedurë shkakton punë dhe kohë shtesë dhe gjithashtu vonesë për klientin.

→ Kapacitetet e stafit

Referuar zhvillimeve të vazhdueshme të standardizimit në nivel evropian dhe ndërkombëtar, stafi ka kapacitete të limituara si pasojë e mosnjohjes mjaftueshëm të kompjuterit (aplikimin e databazës SMIS) dhe gjuhës angleze.

→ Kompjuterë dhe UPS

Janë katër kompjuterë të cilët pas vlerësimit nga IT janë konstatuar se duhet të zëvendësohen me të rijë, ndërsa pajisje për ruajtjen e energjisë nuk kanë asnjë zyrtarë të AKS.

→ Hapësira punese

Janë vetëm dy zyra ku vepron i gjithë stafi i AKS. Këto hapësira punuese janë shumë të vogla dhe si të tilla nuk mundësojnë zhvillimin e takimeve të KPS dhe KT, dhe gjithashtu as të zhvillimit të qendrës së informacionit për standarde “Info Center”.

17. Sfidat e standardizimit kosovar

- Ndërtimi i Sektorit të Certifikimit në AKS, duhet patjetër të vlerësohet nga ekspertë ndërkombëtar nëse përfundimisht duhet të ngritën kapacitete dhe staf shtesë apo të mbetet vetëm në formën e organizimit të punës për këtë komponentë.
- Ngritja e një qendre të informacionit për standarde (Info Center) për të gjitha palët e interesit, është e rëndësishme edhe për AKS edhe për palët e interesit.
- Anëtarësimet në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, nuk janë realizuar, për shkaqe politike. AKS ka kërkuar nga CEN/CENELEC një qasje në standardet EN me ç'rast është realizuar vetëm në format të një "Marrëveshje të Licencuar".
- Krijimi i grupeve punuese (nën komiteteve teknike) për eurokode dhe hartimi i anekseve kombëtare është gati i pamundshëm pa buxhet të caktuar për të mbështetur ekspertët e angazhuar.
- Përkthimi i standardeve mbetet sfida e vështirë, kjo për arsye se procesi i përkthimit është i kushtueshëm, shumë teknik dhe kërkon njohje jo vetëm të gjuhës angleze/shqipe, por edhe të fushës përkatëse dhe se ekspertët e komiteteve teknike nuk mund të realizojnë këtë detyrë mbi baza vullnetare.
- Siguria në punë gjatë pandemisë COVID-19.

18. Plani i punës - AKS 2021

- Plotësimi i kornizës ligjore: Hartimi i rregullores së brendshme për notifikimin e standardeve në Organizatat Evropiane të Standardizimit (CEN dhe CENELEC).
- Implementimi i strategjisë AKS 2020-2025 dhe kornizës ligjore të AKS.
- Promovimi i standardizimit dhe publikimi i çdo standardi të ri të adoptuar si SK.
- Menaxhimi i marrëveshjeve të AKS me organizatat CEN-CENELEC-DPS.
- Anëtarësimi i AKS në ISO; IEC; ITU dhe CEN; CENELEC; ETSI.
- Menaxhimi dhe funksionalizimi i Databazës SMIS dhe WEB.
- Organizim i takimeve të KPS dhe KT.
- Krijim i Komitetit Teknik të ri për shërbime të turizmit.
- Adoptimi i 600 standardeve EN dhe ISO/IEC si SK.
- Shfuqizimi i 500 standardeve të vjetra.
- Ngritje e kapaciteteve profesionale të AKS.
- Ngritja e qendrës së informacionit për standarde (Info Center).
- Rritje e bashkëpunimit me të gjitha ministritë e linjës dhe institucione/biznese tjera që i referohen standardeve.
- Zhvillimi i platformës "ZOOM" si masë anti COVID-19.
- Përshtatje e takimeve në formatin "online".
- Përfaqësim i AKS në asamblatë e përgjithshme të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në iniciativat rajonale dhe evropiane të standardizimit.